

#### REPUBLIKA E SHQIPÊRISÊ

### MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRES

Nr. <u>409</u> Prot.

Durrës, më 17.02.2022

### SHPALLJE 1

### E VENDIT TË LIRË PËR DREJTOR TË INSTITUCIONIT PUBLIK TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (IPAP)

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës , në zbatim të Ligjit 69/2012 "Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërsisë", i ndryshuar, VKM nr.99, datë 27.02.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë,pezullimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar" I ndryshuar, shpall vendin e lirë të drejtorit të institucionet arsimore publik të arsimit paraunversitar IPAP si më poshtë:

NR	DRAP	ZVAP	INSTITUCIONI ARSIMOR
1	DURRËS	TIRANË	INSTITUTI I NXËNËSVE QË NUK SHIKOJNË
		- Price Lines - Store -	"RAMAZAN KABASHI"

## 1. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për vendin e lirë për drejtor të IPAP:

- a) të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- b) të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar", me vlerësimin jo më pak se "Mirë", në kualifikimin e fundit.

c) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij;

d) të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshme përgatitor për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor *ose* të jëtë pranuar për të kryer atë.

e) Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

### 1. Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP përmban:

- a) jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- b) kopjen e njësuar me origjinalin të librezës së punës;
- c) kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- d) tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- e) certifikatën e drejtuesit të IPAP ose vëretimin nga shkolla e Drejtorëve që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor.
- f) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- g) vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- h) deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

# Drejtori aktual i IPAP ose zëvendësuesi i tij vë në dispozicion të secilit aplikant një kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- a) planin afatmesëm të shkollës;
- b) planin vjetor të shkollës të vitit paraardhës;
- c) raportin vjetor të shkollës të vitit paraardhës

Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në pikën 2 ,të shkronjës B, dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në ZVAP-në përkatëse jo më vonë se data **03.03.2022**.

## 2. Data e shpalljes së rezultateve të verifikimit paraprak të dokumentacionit.

Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen jo më vonë se data **07.03.2022.** Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.

### 3. Pas vlerësimit të dosjeve aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë do të E ARS kryejnë intervistën e strukturuar për:

Fusha e njohurive dhe aftësitë në drejtimin e institucionit mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar:

- a) Ligji 69/2012 "Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërsisë", i ndryshuar,
- b) Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2021-2026.
- c) Urdhër nr.31, datë 19.01.2020 "Për miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".
- d) Udhëzim nr.12, datë 10.06.2021 "Për procedurat e pranimit të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë".
- e) Udhëzimi nr 30, datë 12.09.2018 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar".
- f) Udhëzimi nr.2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezul!imit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", i ndryshuar.
- g) Udhëzimi nr 3, datë 09.02.2022 "Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar".
- h) Ligji nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".
- i) Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.
- j) Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.
- 4. Rezultatet përfundimtare të konkurimit do të shpallen në këndin e njoftimeve të institucionit arsimor përkatës sipas përcaktimeve në udhëzimin nr.2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit,uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", i ndryshuar Kreu 1, shkronja C, pika 10/g.

5. Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit brenda 3 ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit.

6. Procedurat e mëtejshme vazhdojnë sipas Kreut 1, shkronja D të Udhëzimit.

EARSIM

